



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 6 Maj 2022

Nr. 159

V E N D I M
P Ë R

**“SHQYRTIMIN E DENONCIMIT TË INSTITUCIONIT TË PRESIDENTIT NDAJ
SUBJEKTIT ZGJEDHOR “PARTIA DEMOKRATIKE” PËR SHKELJE
ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E
PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022”.**

Sot më datë 06.05.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim denoncimin që i përket:

Kërkues: Institucionit të Presidentit

Objekti: Shkelje administrative e parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor

Ndaj: Partisë Demokratike

Baza Ligjore: Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” e “n”, pika 2, dhe 77 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit



Data: 6 Maj 2022
Nr. 159

“Për shqyrtimin e denoncimit të Institucionit të Presidentit ndaj subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të
Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

V Ë R E N :

I. Vlerësimi paraprak

- 1- Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 896 prot., datë 06.03.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1604 prot., datë 06.03.2022, është paraqitur një denoncim ku kërkohet verifikimi dhe procedimi administrativ për thyerjen e heshtjes zgjedhore në zgjedhjet e pjesshme të mbajtura në datën 6 mars 2022.
- 2- Në këtë shkresë pretendohet se “Në faqen zyrtare të rrjetit social “Facebook” të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, rreth orës 19:00 të datës 05.03.2022, është publikuar një material filmik me titullin “**! Kujdes: Çdo votë për kandidatë e Metës është votë për Ramën!**” Nëpërmjet këtij materiali, Partia Demokratike ka cënuar figurën e Kreut të Shtetit dhe ka shkelur nenin 77 të Kodit Zgjedhor.
- 3- Bashkëlidhur denoncimit të kërkuesit është paraqitur materiali CD ku tregohen të dhënat e mësipërme.
- 4- Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.
- 5- Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:
 - dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
 - f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.
- 6- Referuar nenit 7, të ligjit 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.
- 7- Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, çmon të vijojë procedurën administrative ndaj “Partisë Demokratike”, ndaj të cilit atribuohen veprimtari administrative, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

II. Rrethanat e faktit

- 8- Në denoncimin e raportuar pretendohet se “Partia Demokratike”, nëpërmjet postimit të datës 05.03.2022 në faqen zyrtare saj në “Facebook”, ka thyer heshtjen zgjedhor të parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor.
- 9- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi të rëndësishme të administronte si material të dosjes hetimre, vendimin nr. 4, datë 22.01.2021, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

III. Analiza ligjore

- 10- Referuar nenit 77 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, “Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve. Dita përpara datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve, deri në orën e mbylljes së votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore nëpërmjet organeve të medias, si dhe zhvillimi i mitingjeve ose i veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore.”
- 11- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se referuar momentit të publikimit të materialit propagandistik, përkatësisht në datë 05.03.2022, ora 19:00, do të përbënte thyerje të heshtjes zgjedhore në rast se do të kryhej fushatë zgjedhore nëpërmjet **organeve të mediave, zhvillimit të mitingjeve, ose veprimtari të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore.** Megjithatë, referuar

vendimit nr. 4, datë 22.01.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, **Facebook-u apo media të tjera sociale nuk bëjnë pjesë në kategorinë “media” që kërkon pika 1, e nenit 92 të Kodit Zgjedhor.**

12- Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton që objekti rast denoncimi ndaj “Partisë Demokratike” është në shkelje të nenit 77 të Kodit Zgjedhor.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f ” e “n”, pika 2, dhe 77 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimin nr. 9, datë 09.03.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S I :

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”.
2. Moskonstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, datë, 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

